

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA MAT**



**RAPORTI TEKNIK**

*Objekti: Menaxhimi I Kordinuar Për Binomin Mjedis – Turizëm,  
Potencial Për Zhvillimin Social Dhe Ekonomik Në NJVV MAT*

**AUTORITETI KONTRAKTOR  
"BASHKIA MAT"**

**PËRGATITI  
“DERBI-E” Sh.p.k**



**DERBI-E STUDIO**  
Ing. Laurent DEDJA



## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	1
1. VENDODHJA KU DO TË ZHVILLOHET PROJEKTI.....	1
1.1 PËRSHKRIMI I ZONËS. ....	1
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....	2
2.1 PROJEKTI PER PERMIRESIMIN E MJEDIS TURIZMIT. ....	2
3. QËLLIMI I SHERBIMIT.....	3
3.1 OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM.....	3
3.2. QËLLIMI I PROJEKTIT .....	4
3.3. PËRFITUESIT.....	4
4. NDIKIMI DHE QWNDRUESHMWRIA E PROJEKTIT .....	5



## HYRJE

Projektet zhvillimit të turizmit, sistemimeve, ndërtimit të rrugëve, rikonstruksionit dhe ndërtimit të rugëve dytësore rezultojnë në krijimin e kushteve lehtësuese për një rajon të dhënë që ka paraqitur vështirësi. Ato së paku përmirësojnë pamjen dhe cilësinë e lëvizjes në rrugët egzistuese. Në një situatë të tillë sidoqë të kryhet ndërtimi ato do të kenë efekte ndikuese në gjendjen natyrore të rajonit. Kjo lidhet si me ndikimet e ndërtimit ashtu edhe me ato të karakterit operativ për shkak të trafikut. Duke vijuar me tej, ndërtimi dhe shfrytëzimi do të ketë ndikime direkte ose indirekte në aspektet social – kulturore dhe social – ekonomike të “status quo-s”.

Natyra e pyetjeve të shumta dhe të ndryshme që lindin në këtë rast kërkojnë marrjen e tyre në konsideratë gjatë aktiviteteve të ndërtimit dhe të shfrytëzimit. Ajo që kërkohet në këtë rast është trajtimi në mënyrë individuale të zonave ku do të zvillohet ndërhyrja dhe impakti ekonomiko social që ato do të kenë.

Objekti i kësaj hyrje – përbledhje për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projektit i cili do të zhvillohet në zonën e Njësisë së vetë qeverisjes vendore MAT është:

- të minimizojë streset në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si rruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajërhit.
- të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të rreja të ndërhyrjes pozitive dhe ekologjike, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, te cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedist biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

## 1. VENDODHJA KU DO TË ZHVILLOHET PROJEKTI.

### 1.1 Përshkrimi i zonës.

Zona ku parashikohet të zbatohet ky projekt shtrihet në disa nga pikat me rëndësi të madhe kulturore, sociale, etj. Dukeqënse ky projekt përfshin zona të cilat kryisht janë zona rurale, kemi të bëjmë me me një sipërfaqe relativisht te vogel tipologjite e objekteve të cilat shtohen në këto zona.

Gjithashtu dhe infrastruktura e këtyre zonave relativish nuk mund të klasifikohet si një infrastrukturë gjithëpërfshirëse. Këto zona që përfshihen në projekt:

- Kalaja e Koke Malçit, e cila mbart një histori të veçantë për krahinën e Matit, ajo ndodhet në zonën e parkut natyror ronal të Ulzës dhe shumë pranë aksit nacional që lidh Qytetin e Burreli me qytetet veri-perëndimore dhe veriore të Vendit.
- Varri i Turkut i cili tërheq një numër të turistëve të cilët kryejnë pelegrinazh, ai gjendet në afërsi të fshatit VIG në njësin administrative LIS, pranë një prej atrksioneve të tjera turistik të zonës si livadhi i mad Mazdre.
- Kalaja e Stelushit (gjithashtu quhet Kalaja e Varoshit ose Kalaja e Skënderbeut) është një kala që ndodhet në skajin verilindor të luginës së Matit afér fshatit Viq, në kufi me fshatrat Shëlli, Vinjallë dhe Qafëmurrë, në Shqipërine veriore.



- Në fshatin Bruç të Njësisë Administrative Rukaj në Bashkinë e Matit ndodhen disa shpella të cilat mbajnë histori, por janë edhe një atraksion ideal turistik.
- Shpella e Nezirit e cila ndodhet në veriperëndim të fshatit Bruç. Duke gjykuar nga raportet e gërmimit në terren 1979-1985, zona e hyrjes menjëherë pas vijës së pikimit duket se mban potencialin më të lartë për një sekuencë të pa dëmtuar të Pleistocenit. Ajo është përmendur në raportet e mëparshme në terren, se gërmimet në kuadrate të mëdha kur kanë arritur në depozitën e kuqe argjilore janë ndalur në këtë nivel.
- Shpella e Valit apo e “Birme” e cila gjendet jo shumë larg shpellës së Nezirit dhe është një tjetër shpellë me përmasa të mëdha. Teksa zbulon në thellësi të shpellës, anash saj duken stalaktitet e stalakmitet, të cilat kanë ndalur zhvillimin e tyre. Specialistët e fushës thonë se shkak mund të janë bërë kushtet atmosferike brenda shpellës për shkak se ajo ajroset në tre drejtime.
- Shpella e Këputës e cila është dhe kjo në zonën e fshatit Bruç. Nisur nga stilet qeramike dhe sipas një serie datash të radiokarbonit të marra në vitin 2014, pjesa më e madhe e sekuencës së holocenit në Këputë daton në neolitin e hershëm dhe të mesëm.

Këto zona janë një pjesë e rëndesishme e rrrethit të Matit. Gjëndja egzistuese e sistemimeve të këtyre zonave është tejet e amortizuar dhe bën kontrast me pjesët e tjera të këtij rrathi. Me rikonstruktionin e sistemimeve këto lagje përfitojnë një rivilizim të jetës sociale, kulturore dhe ekonomike, akses më të mirë me rrugët e brendshme, sistemimin e rrjetit te kanalizimeve të ujerave të bardha, duke përfituar përmirësimin e parametrave të jetës urbane duke përfshirë elementët e gjelberimit, ambienteve rekreative dhe sociale si dhe duke permirësuar nivelin e shërbimeve që ofrohen në Bashki dhe më gjërë.

## 2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .

### 2.1 Projekti per permiresimin e mjedis turizmit.

Bashkia Mat është një NJVV qe ka në administrim të saj 8 njësi administrative të cilat janë të shtrira në një territor prej 493 km<sup>2</sup>. Disa njësi administrative janë në distanca të largëta nga qëndra administrative Burrel dhe si rrjedhojë disa shërbime ofrohen me vështirësi dhe jo në kohën e duhur. Kjo është më shumë e theksuar në fusha siç është mbrojtja e mjedisit në situata emergjente, shërbimet me hapësira çlodhëse për të rinjtë e zonave apo ngritja e strukturave të shërbimeve për turistet që vizitojnë këto zona. Kjo situatë ka krijuar disavantazhim, mos zhvillim madje edhe rezikim të potencialit mjedor e turistik që kanë disa njësi administrative strategjike për Bashkinë Mat.

Si rrjedhojë nevojitet ngritja e një modeli të koordinuar menaxhimi mes qendrës administrative Burrel dhe njësive administrative strategjike, konkretisht ngritja e strukturave ekologjike mbrojtese dhe stimuluese të mjedisit e turizmit. Zonat e propozuara për këtë model, menaxhim i koordinuar, janë:

- Njësia administrative Lis, me një popullsi prej 3500 banorësh, përbëhet nga fshatrat Vinjoll, Gjalish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj, Mallunxë. Nj.Adm. Lis ka një potencial të madh zhvillimi për turizmin pasi është zona ku kalon rruga që lidh me objektet e trashëgimnisë si kalaja e Stelushit, si dhe lidhja e bashkise Mat me Bashkinë Dibër nëpërmjet fshatit Qaf Murrë.
- Njësia administrative Derjan, me një popullsi prej 2000 banorësh, përbëhet nga fshatrat Derjan (fshati qendër), Urxallë, Barbullej, Dukagjin, Gjoçaj, Lami Madh, Zall Gjoçaj.



Kjo zone administrative është arteria kryesore që bën të mundur lidhjen e Bashkisë Mat me Parkun e Zallit Gjocaj si dhe Bashkinë Mirditë. Kjo zonë ka dhe një sërë objektesh të rëndësishme me potencial turistik si Guri I gjatë në Urxallë, monumentin e Kuvendit Dukagjinit, apo Parkun e madh të gështenjave në Dukagjin.

- NJ.Administarive Rukaj, me qendër Bruçin, ka një popullsi prej 2500 banorësh. Kjo zonë ndodhet në rrugën që kalon në korridorin e Matit dhe bën lidhjen me Bashkinë Mirditë. Kjo zonë është e pasur me burime natyrore si shpellat e Bllazit, Nezirit, burimi i Shutrejës dhe Kanioni Urakë.
- Nj. Administrative Macukull, me qendër fshatin Macukull (mbi 1000 metra mbi nivelin e detit) ka një popullsi prej 2000 banorësh. Zonë tepër e pasur me potencial turistik dhe vlera historike, kulturore natyrore si: Rrënojat e kishës së Shën Trinisë në Dasnjanë (Macukull). Shpella e Valcës e vendosur në shpatin e malit të Dejës, në kufi me përruin e Kalvaçit e cila zë një sip prej 2 Ha. Maja e Dejës e cila është e dukshme nga qyteti i Burrelit me një lartësi prej 2246 m dhe mundësi për turistët dhe të apasionuarit për destinacionet malore për alpinizëm dhe ski. Parqe Natyrore si Mbasdejës (pjesa e pasme e malit të Dejës), që i bashkangjitet parqeve kombëtare të Lurës dhe Zall Gjocaj etj.

Për arsyet e distancës dhe mungesës së infrastrukturës, mjedisi dhe turizmi nuk kanë as mbrojtjen dhe as mbështetjen e përshtatshme duke krijuar kështu vështirësi për NJVV Mat në menaxhim dhe ofrim shërbimesh për mjedisin, turizmin si edhe për banorët e zones, cilësinë e jetës së tyre. Për këtë arsyet është e domosdoshme që të fokusohemi në binomin mjedis-turizëm, si ngushtësisht i lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të zonës e të rajonit.

Ky projekt do të përmirësojë cilësinë e shërbimit të NJVV Mat në shërbim të mjedisit dhe turizmit, duke krijuar një model të koordinuar të menaxhimit në ndërhyrje në raste emergjence mjedisore, si edhe në nxitje të turizmit dhe përmirësim të cilësisë së jetës. Do të krijohen e aftësohen grupe komunitare të mobilizimit vullnetar në të katër njësítë administrative si edhe do të rritet ndërgjegjësimi i banoreve ne lidhje me mjedisin e turizmin, dhe do të përmirësohet situaçia social-ekonomike në zonë.

### 3. QËLLIMI I SHERBIMIT.

#### 3.1 Objektivi i pergjithshem.

Fuqizimi i kapaciteteve menaxheriale të NJVV Mat permes përmirësimit të infrastrukturës me impakt në mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit, turizmit dhe cilësisë së jetës. Përmes projekteve do të bëhet e mundur që të ngrihen qendra multifunksionale për mjedisin dhe turizmin, ku do të jenë të integruara qendra të ndihmës së shpejtë në raste emergjence mjedisore, ambiente rekreative për të rinjtë, banorët e zonës dhe turizmin në natyrë, si edhe ekspozitorë për promovimin e resurseve turistike dhe produkteve unike të zonës.

Objektivi i përgjithshëm do të bëhet i mundur falë përbushjes së Objektivi Specifik 1: Permiresimi i kapaciteteve vendore ne mbrojtje dhe mbështetje te potencialit mjedorës dhe turistik te NJVV Mat si model për të përmirësuar shërbimin dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik lokal dhe rajonal dhe përmirësim të cilësisë së jetës të banorëve të zonës dhe Objektivi specifik 2: Rritja e aftësive të NJVV Mat për planifikim, menaxhim,



prokurim, kontroll dhe monitorim si hartuese dhe zbatuese e projektit nën mbikqyrjen e FSHZH-së. Përmes përmirësimit të kapaciteteve fizike dhe aftësimit të burimeve njerëzorë, arritjes së rezultateve të parashikuar dhe implementim të planit të aktiviteteve të parashikuar për këtë projekt.

### 3.2. Qëllimi i projektit

Ky projekt do të përmirësojë cilësinë e shërbimit të NJVV Mat në shërbim të mjedisit dhe turizmit, duke krijuar një model të koordinuar të menaxhimit në ndërhyrje në raste emergjence mjedisore, si edhe në nxitje të turizmit dhe përmirësim të cilësisë së jetës. Do të krijojen e aftësohen grupe komunitare të mobilizimit vullnetar në të katër njësität administrative si edhe do të rritet ndërgjegjësimi i banoreve ne lidhje me mjedisin e turizmin, dhe do të përmirësohet situata social-ekonomike në zonë. Ky do të jetë një model suksesi për tu replikuar edhe me tej në nivel rajoni.

### 3.3. Përfituesit

Grupet kryesore të interesit dhe njëkohësisht përfitues përfundimtar në këtë projekt propozim janë:

- Autoritetet lokale dhe rajonale (Bashkia Mat dhe Rajoni Dibër), si grupe ineteresi me rol direkt në projekt, në suksesin e tij dhe rezultatet e synuara. NJVV Mat do të jetë përgjegjëse direkte për zbatimin e këtij projekti, monitorimin dhe menaxhimin e tij, duke rritur kësidoj kapacitetet në fushën e menaxhimit të projekteve në nivel lokal.
- Të rinjtë, gratë, banorët e 4 Njësive Administrative, përfshirë këtu personat me aftësi të kufizuar si përfitues direkt dhe perfundimtar në këtë projekt. Kemi realizuar 2 takime konsultuese me banorët e fshatrave dhe administratorët në lidhje me vizionin e bashkisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e potencialit mjedisor dhe turistik të këtyre zonave
- Turistët vendas (shqiptar) dhe të huaj (98.971 turistë kanë vizituar rajonin Dibër në 2023) të cilët do të luajnë një rroll të rëndësishëm në promovimin e ofertës turistike dhe në eksperiencën unike.
- Banorët e Bashkisë Mat dhe Rajoni Dibër gjithashtu janë grupe kryesore interesit sepse projekt do të kontribuojë drejtpërsëdrejti në ndërtimin e një modeli ekologjik miqësor për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit, duke ndikuar kësidoj në përmirësimin e situatës sociale dhe ekonomike përmes shfrytëzimit të potencialit mjedisor dhe turistik të vendit.

Përfituesit përfundimtar të tjerë të këtij projekti vlerësohen të jenë: Sektori i turizmit, sektori i mjedisit si edhe situata e Kohezionit social në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, si sektor kyç.

Logjika e ndërhyrjes së projektit “Menaxhimi i koordinuar për binomin mjedis- turizëm, potencial për zhvillim social dhe ekonomik në NJVV Mat” bazohet në tre shtylla kryesore:

- fuqizimi i kapaciteteve vendore në mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit dhe turizmit përmes infrastrukturës miqësore ekologjike – pajisjes me mjetet e domosdoshme dhe krijimin e ambjenteve multifunksionale
- rritje kapacitesh vendore në menaxhimin e projekteve përmes realizimit të gjithë ciklit të menaxhimit të projektit dhe
- ndergjegjesim të banorëve për përfshirjen e tyre në rrjetëzimin mjedisor-turistik-social permes fushatave të ndërgjegjësimit dhe përfshirjes në aktivitete komunitare.



Qendrat ekologjike do të jenë në formën e qendrave rekreative që do të shërbejnë si qendra multifunksionale përmenaxhim të kordinuar të çështjeve mjedisore dhe turistike, përmes qendrës së ndihmës së parë mjedisore në raste emergjence mjedisore, përfshirjen e banorëve vendas në mbrojtje dhe zhvillim të njësive turistike përmendur, diversifikimin e paketës turistike përmendur zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, si dhe një oazë i përgjithshëm i mbështetjes të produktit tradicional, artizanal vendas, ku komuniteti do të gjëzojë nga aktivitetet e larmishme.

Duke vlerësuar situatën aktuale në bashkinë Mat, konkretisht kapacitetet njerëzore si edhe vlerësimin e potencialit mjedisor, turistik dhe human në zonat e përzgjedhura përmendur të zbatuar këtë projekt, vleresojmë si faktor rrisku: kushtet atmosferike që mund të shkaktojnë vonesa në punime. Rrisk tjetër që ne parashikojmë është paragjykimi/hezitim i banorëve të zonës ne impaktin që do të krijojë ky investim, përmendur këtë do të bëhet punë ndërgjegjësuese, si edhe rritje kapacitetesh mbi parime gjithëpërfshirëse. Rrisk madhor vlerësohen forcat madhore.

#### 4. NDIKIMI DHE QWNDRUESHMWRIA E PROJEKTIT

Ndikimi që projekti do të ketë të grupet e synuara dhe te përfituesit përfundimtar është në disa plane si:

- NJVV Mat do të rrisë kapacitetet, do të përmirësojë cilësinë e ofrimit të shërbimit përmes krijuarit të modelit të menaxhimit të koordinuar përmendur çështje mjedisore dhe turizëm.
- Katër njësi administrative në NJVVB Mat do të kenë Qendra ekologjike mjedisore-turistike përmendur mbrojtje përmendur mjedisin dhe nxiti përmendur zhvillimin e turizmit
- Katër grupe komunitarë të mobilitetit vullnetar do të aktivizohen në këto njësi administrative
- 10.000 banorët e njësive administrative do të përfitojnë nga ky model, duke pasur më shumë siguri përmendur marrjen e shërbimit cilësor në rastet e emergjencave mjedisore, më shumë vëmendje përmendur zhvillimin e potencialit turistik, si edhe ambjente rekreative përmendur argëtim dhe socializim
- Rajoni Dibër, sektori i njësive turistike përmendur dëshmorët e zhvillimit

Përmes ngritisës së këtyre qendrave në secilën njësi administrative do të krijohet një model i koordinuar menaxhimi mes qendrës administrative Burrel dhe njësive administrative periferike, model ky që do të qëndrojë dhe do të vazhdojë edhe në vijim si model shërbimi përmendur çështje mjedisore dhe turizmit. Duke i dhënë kështu zgjidhje sfidave aktuale të NJVV Mat por jo vetëm. Potenciali mjedisor dhe turistik i NJVV Mat është pasuri e gjithë rajonit, e si rrjedhoje kontributi në këto pika strategjike do të ketë impakt në nivel rajonal, në mbrojtje të njësive turistike përmendur, dhe zhvillim te potencialit turistik.

Ky projekt do të jetë i qëndrueshëm në vijim në aspektet:

- a) Qëndrueshmëri financiare: NJVV Mat do të vërë në dispozicion burimet e ardhurave përmendur mbuluar të gjitha kostot e ardhshme operative dhe të mirëmbajtjes;



b) Qëndrueshmëri institucionale: struktura që do të ngrihet në modelin e koordinuar të menaxhimit, krijimi i grupeve vullnetare të mobilitetit, aftësimi i banorëve në zonë për të vepruar në raste emergjence, ndërgjegjësimi i tyre në lidhje me potencialin e mjedisit dhe turizmit do të bëjë të mundur që rezultatet e projektit të vazhdojnë të janë funksionalë edhe pas përfundimit të projektit. Ky projekt do të jetë në pronësi të Bashkisë Mat dhe menaxhimi i ambjenteve rekreative do të jetë në përdorim për menaxhim në marrëveshje më tej me anë të njësive administrative Rukaj, Macukull, Derjan, Lis si dhe Drejtorisë për mbrotjen e mjedisit në bashki.

c) Qëndrueshmëri mjedisore: ky projekt është ideuar bazuar mbi nevojën aktuale të NJVV Mat në lidhje me çështjet mjedisore, ndërhyrjet në rastet e emergjencave, mbrojtjen e mjedisit si edhe në lidhje me çështjet e zhvillimit të potencialit turistik në katër prej njësive administrative me potencial strategik në NJVV Mat.

Përmes ngritjes së katër qendrave ekologjike ndikimi në mjedis do të jetë në disa plane;

- në përdorimin e materialeve ekologjike, duke ndikuar kësosoj në uljen e shkallës së ndotjes dhe qëndrueshmëri ekologjike
- në krijimin e infrastrukturës së domosdoshme (blerjen e bazës materiale) për të ndërhyrë në rastet e emergjencave mjedisore (zjarre) si model i koordinuar menaxhimi i këtyre rasteve duke rritur kësosoj shkallën e mbrojtjes në kohë në këto zona periferike
- në ndërgjegjësimin e banorëve të zonës në lidhje me potencialin mjedisor dhe rolin e përgjegjësitë e individit, duke krijuar këshfu një qasje më të përgjegjshme ndaj mjedisit
- në aftësimin, rritjen e kapaciteteve të grupeve vendore komunitare duke krijuar kësosoj struktura të qëndrueshme në nivel lokal.

#### RELATOI

“ DERBI-E” shpk

Ing. Laurent Dedja



Digital signature by  
Shkelqim Dezhgjiu  
Dezhgjiu  
Date: 2024.10.11  
14:10:43 +02'00'